VENDIM
Nr. 338, datë 16.5.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 660, DATË 12.9.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 1.II, shkronja "a", 10, pika 3.I, shkronjat "a" e "b" dhe 72, pika 5.I, shkronjat "a" e "b" të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të neneve 3 shkronja "e', 4, 6, shkronja "a", 7, 8 e 16, pika 1 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1 "Lista e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, aksionet e të cilave do të transferohen në njësitë e qeverisjes vendore (NJQV)", nr. 31-Ujësjellësi Shkodër, Fshat, ndryshohet sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha